VENDIM
Nr. 102, datë 4.7.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBANIAN GREEN ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "ç" të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "d"; 5, pika 1, germa "d"; 10, pikat 3, 6 dhe 7 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19 pika 1 gërma "a" e "Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

ERE, me vendimin nr. 68, datë 11.5.2017, vendosi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se u konstatua mungesë e dokumentacionit teknik, si dhe mungesa e pagesës së aplikimit për pajisje me licencën e furnizimit të energjisë elektrike.

ERE, më shkresën nr. 352/2 Prot., datë. 22.5.2017, njoftoi subjektin "Albanian Green Energy" sh.p.k. për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Shoqëria "Albanian Green Energy" sh.p.k., me shkresën nr. 059 Prot., datë 6.6.2017, paraqiti në ERE brenda afateve të përcaktuara në nenin 10, pika 7 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dokumentacionin e munguar për të plotësuar aplikimin e tij, si dhe kreu pagesën e aplikimit për pajisjen me licencë furnizimi me energji elektrike.

Aplikimi i shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat "a", "b", "c", "e", "f", "a1", "b1", "c1") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti